



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/189  
Datë: 23.02.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 59 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158 dhe me Ligjin Nr. 08/L-214, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2024, merr këtë:


**V E N D I M**

- Qeveria e Republikës së Kosovës, për tri (3) pozitat për anëtarë të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës, këta kandidatë:
  - Habib Basholli;
  - Nasuf Mjekiçi;
  - Bahri Karaça;
  - Avdi Mjeku;
  - Hasan Preteni;
  - Kaltrinë Demiri.
- Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin dhe biografitë e kandidatëve të propozuar t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Qeveria e Republikës së Kosovës, ka pranuar nga Komisioni përgjegjës, 9 emra si propozim për emërim në 5 vende të parapara me legjislacionin në fuqi për bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale ("KPMM"). Ligji Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale, me plotësim/ndryshimet sipas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, parasheh që duhen propozuar së paku 2 anëtarë për çdo pozitë në bord të KPMM-së. Komisioni përgjegjës, megjithatë, ka dërguar 9 propozime. Më tutje, Komisioni përgjegjës nuk ka marrë parasysh Ligjin Nr.05/L-020 për Barazinë Gjinore, që kërkon përfaqësimin e grave, në qëllim të arritjes së përfaqësimit të barabartë. Duke pasur parasysh nevojën e emërimit të një bordi funksional, së paku prej 3 anëtarëve që mundësojnë kuorumin, e për të zbatuar Ligjin në fuqi për Barazinë Gjinore, duke u siguruar që Kuvendit të Republikës së Kosovës i dërgohen 6 kandidatë të ranguar me poentim më të lartë sipas listës së pranuar nga Komisioni përgjegjës, gjithmonë të udhëhequr nga interesi publik që në radhë të parë bazohet në efikasitetin e punës të institucioneve publike, Qeveria e Republikës së Kosovës vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI

PËR   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/189  
Datë: 23.02.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 25 paragrafit 4. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për rritjen e kufirit të shpenzimeve në shumë prej 10,000,000€ (dhjetë milionë euro), për projektin "Rehabilitimi i Linjës X Hekurudhore (Fushë Kosovë -Hani i Elezit)", nga fondet e huamarrijës kaluzola e investimeve.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi alokohen në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kod 205, në nën-programin "Departamenti i Transportit Tokësor" me kod 45900, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale" në projektin "Rehabilitimi i Linjës X Hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Elezit)" me kod 15046, nga fondi i huamarrijës klauzola e investimeve 06.
3. Rritja e kufirit të shpenzimeve për projektin "Rehabilitimi i Linjës X Hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Elezit)" të ratifikuar në Kuvend, bëhet për mbulimin e obligimeve të projektit nga Kredia me Bankën Evropiane për Investime si pjesë e Klauzolës së Investimeve, dhe nuk ndikon në tejkalimin e kufirit të deficitit sipas rregullës fiskale.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

*PËR*  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë